

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË AKSIONARE
“UJESJELLES KANALIZIME DROPULL “SH A”

Sot, ne Dropull më datë 21/12/2017, une aksioneri themelues:

1. *Bashkia Dropull, e përfaqësuar sipas Vendimit të Keshillit Bashkiakte nr 62 dates 21/12/2017 nga Kryetari i saj Z. Ahilea DECKA, i biri i Kristoforit shtetas shqiptare, i datëlindjes 10/09/1968, lindur në Vriseras dhe banues në Jorgucat, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se indentitetit me nr. . G80910027A*

Themelojme kete shoqeri aksionare me emertim ujesjelles-kanalizime Dropull sh a me aksionare te vetem Bashkine Dropull.

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare “UJESJELLES-KANALIZIME DROPULL “SH A” ne formën e një Shoqërie Aksionare. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë Shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri UJESJELLES-KANALIZIME DROPULL “SH A” sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është për funksionimin, mirmbajtjen, dhe furnizimin me uje te pishem per qytetaret e Bashkise Dropull.

NENI 3

Emri, logo dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridik me logon dhe emetimin e saj UJESJELLES-KANALIZIME DROPULL “SH A”

Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr 115/2014 “për ndarjen administrative_territoriale të njësive të qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperisë është:

- a) Sherbimi i furnizimit me ujë te pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij.
- b) Mirmbajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me ujë te pijshëm
- c) Prodhim i dhe/ose blerja e ujit per plotësimin e kerkese se konsumatoreve
- d) Mirembajtja e sistemeve te ujërave te ndotura, si dhe te impianteve të pastrimit te tyre.

2. Shoqeria duhet te realizoje ç’dolloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj ne perputhje me lejet, autorizimet, licensat sipas legjislacionit ne fuqi.





NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

Selia e Shoqërisë :

Në qender te Fshatit Sofratik, ish zyrat e Komunes Dropull i Poshtem, me nr pasurie 212/15, distanca nga rruga nacionale Gjirokaster-Kakavie 150 m.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 000 leke ndare ne 10 000 aksione me vlere nomionale 1 000 leke (. Aksionerët themelues të Shoqërisë Tregtare "UJESJELLES-KANALIZIME DROPULL "SH A" zotërojnë aksionet në këtë Shoqëri si më poshtë:

- *Bashkia Dropull* , zotëron 100% te aksioneve dhe eshte pronar i vetem i shoqerise, "UJESJELLES - KANALIZIME SH A DROPULL".

NENI 7

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në vlere i aksionarëve themelues të kësaj Shoqërie.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve – organi më i lartë vendimmarrës;

Këshilli i Administrimit – organ i Administrimit;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

NENI 9
Këshilli i Administrimit

Këshilli i administrimit i Shoqërisë përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

- Z.Alqi Kazaqi i biri i Apostol shtetas Shqiptar i ditlindjes 6/7/1970 lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Frastan-Gjirokaster, person madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr H00706029G ne cilesine e antarit
- Znj.Thalia Pulla e bija e Vasilit shtetase shqiptare e ditlindjes 26/3/1960 lindur Gjirokaster dhe banuese ne Terihat-Gjirokaster person madhor me zotesi te plote per te vepruar mmajtese e ID G05326029L ne cilesine e kryetarit
- Z. Andi Papa i biri i Dhimitri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/07/1981 , lindur në Fier dhe banues ne Goranxi-Gjirokaster person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se indentitetit me nr. I10718086R ne cilesine e antarit
- Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit te administrimit do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një afat 3 vjeçar.

Administatori i Shoqërisë “UJESJELLES-KANALIZIME DROPULL”SH A” është Z.Alqi Kazaqi i biri i Apostol, shtetas shqiptar, i datëlindjes 6/07/1970, lindur në Gjirokaster, dhe banues ne Frastan Gjirokaster person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se indentitetit me nr.H00706029G Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Admintratori i saj Z. Alqi Kazaqi, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe, kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

NENI 13



Eksperti kontabel i shoqerise do te jete Konstandin Pesha, i datelindjes 02/07/1960 me license per te ushtruar profesionin e audituesit ligjor, sipas vendimit te komitetit te regjistrimit nr 163 date 19/07/2007.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u gjet sipas vullnetit te aksionarit themelues dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e tij para noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

AKSIONARI I SHOQËRISË

BASHKIA DROPULL

përfaqësuar nga

Kryetar

AHILEA DEÇKA

